



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/20023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 19.03.2025, nxjerrë këtë:

## V E N D I M

- I. Mbyllt rasti me nr. Protokolli- NXVEKJ-0016-03-01/2025, për zyrtarin z. Artan Krasniqi, shefi i Departamentit së Sociologjisë, në Fakultetin Filozofik, Universiteti i Prishtinës, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

## A r s y e t i m

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia) ka filluar trajtimin e këtij rasti pas informatës së pranuar nga jashtë (në vijim: raportuesi i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit pasi që, siç theksohet në kërkesë (citojmë): “*Artan Krasniqi është zgjedhur Kryetar i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore agjenci e pavarur në kuadër të Kuvendit të Republikës se Kosovës, gjithashtu i njëjti është duke mbajtur edhe pozitën e shefit të Degës së Sociologjisë në Kuadër të Universitetit të Prishtinës. i Njëjti në KKTK ka caktuar pagën primare kurse në UP sekondare. Mirëpo në bazë të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, një zyrtar nuk mund të mbajë 2 pozita drejtuese në institucione publike. Besoj se ky është një konflikt interesit edhe si i tillë ju lutem që të verifikoni*”.

Agjencia konform mandatit dhe kompetencave ligjore që ka sipas Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka trajtuar dhe shqyrtau pretendimet për konflikt të interesit, përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, sipas dispozitave të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), përkizazi me mbajtjen e pozitës *Shef i Departamentit të Sociologjisë*, krahas funksionit tjeter *Kryetar i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore*, nga z. Artan Krasniqi.

Konform dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia ka njoftuar zyrtarin Artan Krasniqi lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit (shkresa zyrtare: DPKI-174/25). Më pas, me qëllim të sqarimit të plotë

dhe të gjithanshëm të kësaj situate është organizuar dhe mbajtur një takim me zyrtarin në fjalë, me ç'rast i njëjtë është njoftuar me pretendimet e raportuesit të rastit si dhe me informatat që posedon Agjencia lidhur me këtë rast.

Në takim, zyrtari ka paraqitur argumentet dhe qëndrimet e tij lidhur me pretendimet e ngritura, duke paraqitur edhe prova (dokumentacion) përkizazi me deklarimet dhe sqarimet e tij. I njëjti, ndër të tjera ka theksuar se, Këshilli i Fakultetit Filozofik me vendim e ka emëruar atë shef të Departamentit të Sociologjisë, pozitë kjo jo-menaxheriale apo drejtuese, pa vartës nën menaxhim të tij, ndërsa i raporton dekanit të Fakultetit Filozofik. Tësia, ka sqaruar se detyrat dhe përgjegjësitë e kësaj pozite nuk janë të shkruara, por kryesisht lidhen me organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor në Departament.

Gjithashtu, z. Artan Krasniqi ka sqaruar se Fakulteti Filozofik ka qenë në dijeni se i njëjti është zgjedhur kryetar i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore (në vijim: KTK), dhe se kjo situatë nuk është parë si pengesë për faktin se ai mban edhe pozitën e shefit të Departamentit. Ai ka deklaruar gjithashtu se ka bërë kërkesë për shqyrtim nga Universiteti që të kaloj me pagë sekondare në UP, ndërsa me pagë primare në KTK, për çfarë ka deponuar në Agjencin dokumentacionin (kërkesat) në fjalë.

Me qëllim të sqarimit të plotë të situatës dhe konstatimit të drejtë të gjendjes faktike, Agjencia përmes shkresës zyrtare DPKI-222/25, ka kërkuar nga Universiteti i Prishtinës informatat vijuese: “[...] Cili është statusi juridik i departamenteve të fakulteteve të Universitetit të Prishtinës, përkatësisht, cili është statusi i (shefit të) departamentit të sociologjisë në kuadër të Fakultetit Filozofik? A konsiderohet organ drejtues (shefi) departamenti i sociologjisë në kuadër të Fakultetit Filozofik/Universiteti i Prishtinës? Cili është roli dhe mandati i shefit të departamentit në kuadër të Fakultetit/Universitetit të Prishtinës? [...]”

Duke vepruar sipas kërkesës si më lartë, Universiteti i Prishtinës ka dërguar në Agjencin përgjigjen përmes shkresës zyrtare Nr. Prot. 413, dt.05.03.2025, me të cilën ka sqaruar se:

“Bazuar në Statutin e Universitetit të Prishtinës, organizimi dhe përgjegjësitë e departamenteve në kuadër të njësive akademike rregullohen sipas Nenin 45:

3. Fakultetet vendosin për organizimin e brendshëm të tyre duke krijuar:

3.1. Departamentet (fusha të përgjithshme të shkencës apo arteve), përfshirë rregullat për organizimin dhe funksionimin e tyre;

4. Departamentet janë pjesë përbërëse e fakulteteve; [...].

9. Njësítë akademike zhvillojnë rregullore të brendshme për organizimin e tyre për detyrat dhe përgjegjësitë e shefave dhe sekretarëve të departamenteve në raport me përgjegjësitë e dekanatit, këshillit të fakultetit dhe komisionit të studimeve në njësinë akademike. Këto rregullore miratohen në këshillin e fakultetit.

Departamentet funksionojnë brenda fakultetit nën mbikëqyrjen e Këshillit të Fakultetit.

Universiteti i Prishtinës përbëhet nga Njësítë Akademike (fakultetet) dhe Njësítë Organizative (zyrat/departamentet administrative). Njësítë Akademike ofrojnë programe të ndryshme të studimit, të cilat sipas natyrës organizohen në departamente të veçanta për profile të ngushta të studimit. Konkretisht, Departamenti i Sociologjisë ofron dy programe të studimit (Sociologji

*Bachelor dhe Sociologji Master), të cilat janë fushë e ngushtë që i përkasin shkencës së sociologjisë.*

*Departamenti koordinohet nga shefi i departamentit, roli i të cilit është koordinimi i punëve që lidhen me çështjet e ngushta të departamentit. Shefi i departamentit zgjedhet nga Këshilli i Fakultetit, pas propozimit të personelit akademik të po të njëjtit departament. Edhe pse punët, detyrat dhe përgjegjësitë e shefit të departamentit nuk janë të specifikuara në Statutin dhe në ndonjë rregullore të brendshme të UP-së, shefi thërret mbledhjet e stafit të departamentit, koordinon punët që lidhen me përpilimin, rifreskimin dhe përmirësimin e programeve të studimit të departamentit përkatës, pranon kërkesat për barazvlerë të studentëve, etj. Megjithatë, shefi i departamentit nuk është organ vendimmarrës, por është konsultativ dhe propozues pranë Dekanit të Fakultetit dhe Këshillit të Fakultetit. [...];*

*Statuti i Departamentit të Sociologjisë, si dhe i departamenteve të tjera në UP, janë njësi organizative brenda fakultetit përkatës, në të cilën funksionojnë dhe organizohen programet e studimit të fushës së ngushtë të studimit. Roli i shefit të departamentit është një rol koordinues brenda departamentit, i cili nuk ka rol vendimmarrës, por ka një rol propozues ku propozimet përvendosjen e çështjeve të ndryshme paraqiten pran Këshillit të Fakultetit dhe Dekanit.*

*Shefi i departamentit nuk është organ drejtues, por është një person koordinues brenda departamentit.*

*Mandati i shefit të departamentit është të koordinojë punët brenda departamentit që lidhen me zbatimin e programeve të studimit dhe adresimin e çështjeve të studentëve brenda departamentit përkatës.”*

Në këtë mënyrë, Agjencia pasi ka administruar si prova informatat e pranuara nga raportuesi i rastit, sqarimet e z. Artan Krasniqi në takimin e mbajtur në Agjenci dhe dokumentet e dorëzuara nga zyrtari në fjalë, si dhe përgjigjen zyrtare të pranuar nga Universiteti i Prishtinës, ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Me Vendimin Nr. 08-V-779, i datës 30.10.2024, të Kuvendit të Kosovës, me rekomandim të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport, z. Artan Krasniqi është zgjedhur anëtar (kryetar) i KTTK-së;

Me Vendimin Ref. nr. 3235/01, i datës 31.10.2024, të Këshillit të Fakultetit Filozofik, z. Artan Krasniqi është zgjedhur shef i Departamentit të Sociologjisë;

Nga përgjigja e Universitetit të Prishtinës është ri-konfirmuar se, Universiteti i Prishtinës ka subjektivitet juridik pra është institucion, ndërsa njësitë akademike (Fakultetet), e aq më pak departamentet, nuk kanë subjektivitet juridik, por janë njësi organizative brenda fakultetit përkatës, në të cilën funksionojnë dhe organizohen programet e studimit të fushës së ngushtë të studimit. Shefi i departamentit është një rol koordinues brenda departamentit, pra nuk ka rol vendimmarrës, por ka një rol propozues, pra pozita shefi i Departamentit në kuadër të Fakultetit Filozofik, nuk i ka autorizimet e organit drejtues, por është një person koordinues brenda departamentit;

I. Në vështrim të pretendimeve dhe gjendjes faktike të konstatuar si më lartë, Agjencia vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi, se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, për shkak se mbajtja e pozitës dhe ushtrimi i detyrës shefi i Departamentit së Sociologjisë në Fakultetin Filozofik,

Universiteti i Prishtinës, krahas funksionit kryetar i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, nuk bie ndesh me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Agjencia ka pasur parasysh dispozitën e nenit 13 [*Papajtueshmëria me ushtrimin e funksionit publik*], paragrafi 2, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me te cilën është përcaktuar se: "Zyrtari i lartë nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një organi drejtues të ndërmarrjes ne pronësi publike, shoqërisë aksionare me pronë publike si dhe organeve të institucioneve te tjera publike, përvèç nëse parashihet ndryshe shprehimisht me ligj, lidhur me nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.13, me të cilën është përkufizuar nocioni institucion si: "institucion - përfshinë institucionet publike të nivelit qendror dhe lokal, ndërmarrjet e nivelit qendror dhe lokal në te cilat ekziston pjesëmarrje e kapitalit shtetëror ose vendor dhe institucionet e tjera të themeluara me ligj", por ka konstatuar se kufizimet si më lartë nuk vlejnë në këtë rast.

Kjo për faktin se, nga sa u tha më lartë, Universiteti i Prishtinës ka subjektivitet juridik pra është institucion, ndërsa njësitë akademike - fakultetet, e aq më pak departamentet, nuk kanë subjektivitet juridik, por janë njësi (programe) të veçanta në kuadër të Universitetit (si institucion), përkatësisht njësi organizative themelore e punës mësimore në kuadër të fakultetit, prandaj, pozita shefi i departamentit në kuadër të njësisë akademike nuk konsiderohet organ drejtues i institucionit në kuptim të dispozitës së sipërcituar.

Andaj, vështruar nga funksioni kryetar i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, (zyrtar i lartë publik), të cilin e ushtron z. Artan Krasniqi, nuk paraqet konflikt të interesit apo papajtueshmëri me ushtrimin e funksionit publik, mbajtja e pozitës shefi i Departamentit të Sociologjisë në Fakultetin Filozofik, sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

**II.** Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [*Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit*], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përcaktuar se: "Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimitarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.", si dhe paragrafin 15 të këtij nenit, me të cilin është përcaktuar se: "Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative."

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

  
Ylli BULLESHIKAI  
Drejtor i Agjencisë për  
Parandalimin e Korrupsionit

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)